



## **Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

### **Nr. 67**

Datë: 02. 12. 2017, ora: 13:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Adnan Rustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Stevan Veselinoviq, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shef i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

### **RENDI I DITËS**

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;
2. Vendim për caktimin e datës së rivotimit, për zgjedhjet e Raundit të dytë për Kryetar Komune në Istog;
3. Raport i Këshillave të KQZ-së;
  - a. Këshilli për Operacione Zgjedhore;
4. Të ndryshme;

-----

### **1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:**

**Valdete Daka:** Mirë se keni ardhur në mbledhjen e 67 të KQZ-së. E kemi rendin e ditës para jush. A ka dikush vërejtje, propozime? Nëse jo kush është për këtë rend dite?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.

## **2.Vendim për caktimin e datës së rivotimit, për zgjedhjet e Raundit të dytë për Kryetar**

**Valdete Daka:** Pika e parë e rendit të ditës: vendimi për përcaktimin e datës së rivotimit kryetar të Komune në Komunën e Istogut nga Raundi i Dytë! Tashmë, e keni para jush vendimin e PZAP-it i cili është i plotfuqishëm, duke u bazuar në vendimin e gjykatës supreme i cili vendim na obligon që të përsëritet votimi i zgjedhjeve lokale të raundit të dytë për kryetar të komunës së Istogut. Në bazë të këtij vendimi, ne duhet të bëjmë një datë, dhe unë e hapi diskutimin. Në fakt, unë ju kisha drejtuar kryeshefit të Sekretariatit i cili, duhet të na ofroj saktësisht se për kur, në cilën datë janë të gatshëm ata që t'i organizojnë zgjedhjet. Duke marr parasysh që shumë operacione varen nga afate ligjore, Sekretariati duhet të na garantoj se mund të arrihen dhe cilat janë ato data që KQZ-ju mundet ta shpall rivotimin!

**Enis Halimi:** Ne, kemi diskutuar në takimet tona me menaxhmentin dhe zyrtarët e tjerë në lidhje me këtë rivotimin. Dhe, kemi proceduar zgjedhjet tona opcionale në Këshillin e Operacioneve Zgjedhore dhe Këshillin Ligjore të cilat, i kemi të bashkangjitura si materiale që janë trajtuar në këto këshilla dhe implikimet që secili nga këto opsione kanë përkitazi me procesin e rivotimit që, duhet të ndodh në komunën e Istogut. Pra, i keni dy opsione si propozime të cilat, edhe një herë po themi që janë trajtuar në këshillat përkatës....

**Betim Gjoshi:** Teknikisht, ne duhet së pari me marr vendim për cilin version të votimit jashtë vendit jemi, dhe po mbesim për me caktuar datën e zgjedhjeve, sepse kjo edhe e përcakton dhe e determinon atë nëse, kemi regjistrim nga fillimi. Është një nga opsionet që ka sjellë Sekretariati. Duhet kohë më e gjatë për m'u mbajt dita e zgjedhjeve, për këtë ndoshta është mirë datën e vendimin me e shtye si pikë të fundit për arsye se, ndoshta është mirë me i diskutuar këto materialet e këshillave mandej, me vendos për datën e zgjedhjeve...

**Binak Vishaj:** Materialin nuk e kemi, ne, pjesa që nuk jemi anëtarë të këshillave por, edhe për ata të operacionit zgjedhor dhe ligjorë, po akordohem që njëherë të përcaktohet për opsionin se cili duhet të jetë vendimi i KQZ-ës për sa u përket votave me postë. E ky vendim, e bënë të qartë edhe përcaktimin e datës se, janë të ndërlidhura operacionet zgjedhore njëra me tjetrën. Nuk mundemi ta caktojmë një datë zgjedhore që është më e hershme, ndërsa që operacionet zgjedhore mund të jenë më të gjata me afat ligjor dhe nuk munden të ju përmbahen. Kështu që, unë jam që t'i diskutojmë propozimet e Sekretariatit për sa i përket votave, cilat janë ato! Personalisht, po e jap versionin tim. Unë, jam që askush të mos largohet prej listës votuese. Të drejtën për me votuar, ua ka dhënë kushtetuta dhe ligji, qoftë edhe një nëse është...!

Unë jam, tha z. Vishi që të përcaktohen format dhe variantet se si të verifikohen përsëri këta që janë në listën për raund të dytë që janë të verifikuar dhe, të ju kërkohet që t'i sjellin adresat e sakta dhe numrat e telefonave. I gjejmë forma si të kontaktojmë me ta që t'u jepet një afat kohorë dhe ata, duhet të përgjigjen në adresën e saktë, ose që e konfirmojnë që nuk janë ata persona. Unë, nuk jam që të largohen nga Lista Votuese asnjë që ka të drejtë vote sepse, nuk kemi të drejtë. Nuk na e jep askush këtë të drejtë. Vetëm një nëse është që ka të drejtë vote, kjo buron nga Kushtetuta, më saktë nga neni 45, nga Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Lokale....

**Valdete Daka:** Faleminderit. Atëherë, po na mbetet që në fillimisht t'i dëgjojmë këshillat, raportet nga këshillat dhe pastaj, të diskutojmë për probleme të tjera, saktësisht për vendimin, caktimin e datës. Atëherë, fillojmë me raportin e këshillave....

### **3.Raport i Këshillave të KOZ-së**

#### **1. Këshilli për Çështje Ligjore**

**Sami Hamiti:** Faleminderit kryetare. Me thënë të drejtën ne kemi diskutuar gjatë në takim bashkërisht edhe me këshillin për operacione zgjedhore që të kemi solucione ose, si do të jetë varianti më i mirë. Ne, kishim 4 opsione nga drejtorja gjithsesi të procedohet 4 variante dhe në diskutim pak më të gjerë, në përgjithësi ishin këto çka e tha edhe Binaku. Normalisht, edhe nga subjekti im, pasi që kanë ndodhur këto që kanë ndodhur, si qëndrim është që të përjashtohet lista, edhe pse është e vërtetë se çdo njeri e ka të drejtën e vet për me votuar. Pak a shumë, matematikisht e dimë që prej tyre, diku 32 aplikime që kanë ardhur, vota janë të rregullta prandaj, nuk mund të ju a ndalojmë atyre të drejtën që të jenë votues. Në përgjithësi, po them që në këshill ka dominuar mendimi që të mos kemi aplikim të ri për votim jashtë vendit por, të mbete kjo listë e cila do të verifikohet për një kohë nga drejtorja: thjeshtë me atë që vjen që ta ri konfirmoj vendqëndrimin e vet, adresën e vet dhe numrin e telefonit në të cilën mund të kontaktojmë, dhe pjesa tjetër e votuesve të cilët janë hy pa dëshirën e tyre janë në listën jashtë vendit sepse, asi kemi ne. E dimë vetëm ne që i kemi ankimuar: i kemi 400 raste që ata të kthehen në listën e rregullt votuese pra, të mos ju mohohet as këtyre e drejta sepse, një pjesë e madhe e tyre kanë votuar me kusht dhe vota e tyre ka shkuar dëm sepse, është anuluar në kuptimin se ka ekzistuar në listën votuese.

Unë mendoj, tha z. Hamiti se, në një periudhë të shkurtë ai verifikim mund të bëhet, thjeshtë me dokument, me një vërtetim apo me një dokumentim të adresës së saktë se ku qëndron dhe nga aplikon, me numrin e telefonit... Pjesa tjetër që mbetet pa u verifikuar në kuptimin që ka të vdekur...,tash po themi me këto adresa që kanë aplikuar, e që shumica jetojnë në Malit të Zi, në France, në Luksemburg por, le të aplikojnë, le të i japin adresën e saktë, telefonin dhe le ti vërtetohen nga drejtorja...Për ne, opcionale mbeten datat e zgjedhjeve: ajo e 17 dhjetorit ose 24 dhjetor. Faleminderit...

**Betim Gjoshi:** Faleminderit e nderuar kryetare. Edhe një herë d.m.th., kjo që ka ndodh me rastin e vendimeve të PZAP-it dhe Supremes, është një kërkesë emergjente ndaj Kuvendit të Republikës së Kosovës që të filloj reformën zgjedhore dhe të ju sugjeroj votuesve nga diaspora votim pranë përfaqësive diplomatike apo modalitetve tjera. Mënyra se si organizohet votimi jashtë vendit, është komprometua skajshmërisht jo vetëm në Istog por, anembanë vendit, këtë e ka dëshmuar edhe që është proces i pa mbrojtur edhe është lehtë i manipulueshëm për këtë d.m.th. Kuvendi i Kosovës duhet të gjejë modalitete edhe ne si

Komision Qendror Zgjedhor PZAP-i na ka urdhërua që të gjejmë modalitete se si me mbrojtje edhe me bo të mbrojtur këtë proces! Duhet sa më shpejtë që edhe rregullativa dytësore me u përmirësua sa i përket votimit jashtë vendit se, në mënyrën qysh është kemi thënë unë ka vite që e them por, nuk ka has në adresë që është lehtë i manipulueshëm edhe mund të mos kemi votues që votojnë për llogari të vetën por, votues që votojnë në emër tjetër dhe këtë e ndalon edhe ligji edhe kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Sa i përket rastit konkret, tha z. Gjoshi, unë e përkrahi d.m.th., propozimet e kolegëve që folën paraprakisht pra, që të kemi një proces verifikimi se na urdhëron edhe PZAP-i se e kemi d.m.th., detyrim me bo tash me këtë d.m.th., ka mbet në anën e Komisionit Qendror Zgjedhor pse gjejmë mënyra se si ti verifikon, neni 6 i ligjit për zgjedhje të përgjithshme në të cilën thirret dhe ligji për zgjedhjet lokale, thotë që lista votuese përbëhet nga votues jashtë vendit edhe votuesit brenda Kosovës dhe gjithashtu thotë që rregulloret tona rregulloja për raundin e dytë neni 6 kujtoj edhe neni 8 ose 10 thotë që lista votuese është e njëjtë si e raundit të parë a të dytë. Me e pas për bazë këtë, ne votuesit që nuk arrijnë me verifikua adresën edhe kriteret që i bëjnë për jashtë vendit ne duhet ti kthejmë në listën votuese të rregullt, numërimi i votuesve i tërësishëm nuk do të lëviz nuk do të futen në listën votuese personat që mbushin 18 vjet me datë që e caktojmë për Istogun ose votuesit për çdo arsye kanë mundur të lëvizin në Istog pra, do të jetë me të njëjtë votues do të zhvillohet raundi vetëm mund të ndërroj adresa e votuesve jashtë brenda vendit ta kemi të qartë për opinionin publik. Pra, atij numëri që ka qenë në raundin e parë nuk do ti hiqet askujt e drejta për të votuar vetëm mund ti ndryshoj statusi nga votues jashtë vendit të kthehet votues i rregullt.

Për votues jashtë vendit, tha Gjoshi, duhet të sjellin dokumentet që i propozoj edhe këshilli edhe unë mendoj që sekretariati i Komisionit Qendror Zgjedhor për veç një informim që duhet të ja bëjë këtyre votuesve, kontaktet, adresat që i ka me ta duhet të filloj ti kontaktoj nëse kanë e-mail me ju shkrua se e kanë për detyrë mi sjell edhe me ja bo të qartë se cilat janë dokumentet edhe dëshmitë që ne ta përmbushim edhe mos të kemi ndonjë ankesë nga dikush që ja kemi humbur të drejtën kushtetuese siç e ceku Binaku, se nuk është në domenin ton pa marr parasysh që dikush ka mund të keqpërdorë në emër të tyre që ne të ja humbim të drejtën nuk është as në bazën ligjore as mundësin me to. Përndryshe, unë e përsërit vendimin e PZAP-it edhe supremes edhe mendoj që kjo këtu d.m.th. i dhënë disa obligime Komisionit Qendror Zgjedhor edhe institucioneve të Republikës së Kosovës me vepru më tutje jo vetëm në rastin konkret.

**Adnan Rrustemi:** Faleminderit. Së pari, nuk ka asnjë dyshim që votat që kanë ardhur të regjistruara nga Mali i Zi por, edhe nga Serbia kanë qenë sipas një proces tërësisht të orkestruar dhe të manipuluar në kanale, jo ligjore. Kjo nuk është për herë të parë kjo ka ndodh së paku prej vitit 2013-2014 kur aplikacionet edhe fletëvotimet të vijnë në Kosovë nga Serbia dhe Mali i Zi dhe sidomos nga Serbia në mënyrë komplet të kundërligjshme dhe të menaxhueshme nga organet si te themi të shteteve jashtë Kosovës për qëllime natyrisht politike të grupeve të caktuar është po ashtu e qartë që në këtë rast, janë keqpërdorur si për raundin e parë si për të dytin dhe dëmi ka qenë edhe në raundin e parë edhe në raundin e dytë. Ne, duhet ta theksojmë pavarësisht vendimit në këtë rast që nuk është përfshirë edhe të Gjykatës Supreme dhe të PZAP-ës që në bazë të këtyre votave respektivisht dhe rrjedhimisht kundër ligjshëm janë zgjedh edhe tre asamblist në Kuvendin e Istogut të cilët

në zgjedhje të rregullta në vendvotime nuk kanë marr as 50 vota si struktura dhe ky është dëm edhe ligjor edhe dëmton edhe legjitimitetin në Kuvendin komunal në Istog. M'u po më vjen keq natyrisht që vendimi është si i tillë dhe s'kemi zgjidhje tjetër por, duhet me adresua që vendimi as i PZAP-it as i Gjykatës Supreme nuk ka ofruar zgjidhje për këtë çështje dhe jo zgjidhje të drejt për me theksua.

Natyrisht, tha z. Rrustemi që e ka konstatuar gjendjen dhe po pajtohem me atë konstatim por nuk ka ofrua zgjidhje sepse ne e dimë është e vërtetë që në fazën çfarë jemi edhe në këtë rast në rivotimin në Istog është vazhdimësi e proceseve që nga shpallja e datës së zgjedhjeve. Për mu zgjidhje do të ishte natyrisht përsëritja e votimit edhe për asamblist komunal në Istog nuk po them domosdoshmërisht ndoshta edhe për raundin e parë sepse ndikimi i këtyre votave në raundin e parë ka qenë më i vogël më i kufizuar s'ka qenë përcaktues në raundin e parë për kryetar komune por, ka qenë vendimtar për asamble sikurse ka qenë edhe përcaktues në raundin e dytë. Unë megjithatë mendoj që ka hapësirë edhe për prokurori m'u hetuar mënyra qysh është organizuar, qysh kanë ardhur, qysh kanë lëviz në mes të dy raundeve. Në ndërkohë, në fazën që jemi ne nuk mundemi të bëjmë regjistrim të votuesve jashtë vendit për herë të parë është e vërtetë kjo punë por, mund ta bëjmë një verifikim që na udhëzon edhe vendimi i Gjykatës Supreme dhe i PZAP-it. Po thuajse në faza të njëjta të regjistrimit të sigurohem që këta votues janë votues me të drejt vote dhe janë votues që jetojnë jashtë vendit dhe që votimi i tyre të bëhet i rregullt dhe individual dhe vullneti i tyre të bëhet si shtetas i Kosovës dhe jo vullnet i manipuluar.

Në anën tjetër, vlerësoi Rrustemi, nuk pajtohem dhe nuk duhet ta bëjmë këtë shkarje që ta përgjithësojmë edhe me votat e tjera të diasporës nuk kanë asnjë ndërlidhje, janë komplet të ndara. Vendimi i PZAP-it dhe Gjykatës Supreme për rivotime në vendvotime të rregullta në Istog nuk ka qenë i drejt, këto janë operacione të ndara nuk kanë asnjë lidhje. Mbase do të ishte më e drejt të përsëritet votimi veç përmes poste duke i njehur këto proceduara e identifikimit që të mos i torturojmë qytetarët që jetojnë brenda Kosovës, në komunën e Istogut në këtë rast në zgjedhje. Sa i përket datës mendoj që duhet sa më shpejt të jetë, 17 dhjetori në këtë rast është më adekuate për mos mu zgjat edhe mos me krijuar hapësirë edhe për manipulim të radhës me këto vota dhe votues dhe që me përmbyll procesin sa më parë.

Unë, jam dakord për opsionin që u dha nga këshilli për çështje ligjore e që e përcakton natyrisht edhe planin opercaional që e përcakton që këta votues të verifikohen duke kërkuar kritere shtesë në këtë rast për Istogun me u siguruar që janë votues të ligjshëm dhe votojnë në mënyrë të rregullt dhe me konfirmuar. Natyrisht, duhet t'i kemi listat e votuesve të rregullta ku e dimë se ka pasur shumë raste të ngritura madje edhe drejt për drejt në KQZ, të cilat emrat e tyre janë larguar nga lista votuesve të rregullt në vendvotime sepse dikush tjetër ka bërë regjistrimin në emër të tyre. Ju faleminderit.

**Stevan Veselinoviq:** E nderuar kryetare, unë do të ndalem vetëm në diskutimin e mëparshëm që ka të bëjë me votimin jashtë Kosovës, veçanërisht lidhur me fletëvotimet që vijnë nga Serbia, dhe siç u përmend, edhe nga Mali i Zi. Për mua, ky është më tepër një konstatim politik i diskutuesi dhe kolegut, i cili ka për qëllim t'u hiqet në përgjithësi, mundësia e votimit atyre votuesve nga Kosova që, ndodhen jashtë Kosovës: konkretisht, në

Serbi dhe në Mal të Zi. Unë, me të vërtetë nuk shoh asnjë interes nga askush në Serbi dhe në Mal të Zi që të manipulojë me fletëvotimet që vijnë përmes postës në komunën e Istogut. Nuk ekziston asnjë interes, dhe as nuk mendojë që është variant real, dhe më duket sikur është një tendencë për zhvendosjen e ndonjë përgjegjësie nga dikush këtu, tek ndonjë institucion që me të vërtetë, nuk ka lidhje me këtë....

**Adnan Rrustemi:** Duhet me theksuar se ne jemi dëshmitar, mbase zotëria është i ri por, jam i bindur se ka qenë i përfshirë....! Nga 2013 aplikacionet për jashtë vendit nga Serbia dhe Mali i zi kanë ardhur nga kanale të paligjshme: nuk kanë ardhur as nga posta, as nga faksi, as përmes e-mailt... Kanë ardhur në mënyrë fizike të organizuar në pako kolektive, të vendosura pa fah postar të KQZ-së, nuk ka asnjë dyshim për këtë punë. Madje ka qenë edhe aspekti tjetër e kundërligjshmërisë së këtyre votuesve, por është kjo një temë tjetër që duhet me theksuar mos me u përsërit herën tjetër. Si votues, janë legjitimuar por, duhet me i plotësuar kriteret e zotësisë juridike d.m.th., janë regjistruar vetëm në bazë të kartelës së refugjatit që, nuk është dokument i mjaftueshëm për regjistrim, është i mjaftueshëm për regjistrim për identifikim por jo për regjistrim. Kërkohen dokumente shtesë për me dëshmuar që ke jetuar në Kosovë, ke pas prindërit nga Kosova e kështu me radhë. Janë kriteret e përcaktuara e që janë kriteret e njëjta me të shtetësisë.

Kjo, tha z. Rrustemi, ka vazhduar me u përsërit dhe duhet ta themi se kjo është abuzuar pastaj edhe nga qarqet e tjera dhe grupet tjera kështu që, duhet m'i dhënë fund kësaj. Duhet me u ndryshuar ligji, dhe votuesit jashtë vendit duhet me pas mundësi me u regjistruar dhe me votuar në ambasada, në konsullatat e Republikës së Kosovës pa asnjë dyshim por, deri atëherë me bazën ligjore aktuale që kemi, ata që dëshirojnë me votuar jashtë vendit, duhet m'u vërtetuar që jetojnë jashtë vendit dhe natyrisht, m'u siguruar që i plotësojnë kushtet ligjore që janë të njëjta me fitimin e shtetësisë, pak a shumë! Këto janë kritere dhe të ministrisë së Punëve të Brendshme dhe, nuk duhet të lejojmë që të na përsëritet të na vijnë aplikacionet me paketa në mënyrë kolektive dhe të kundërligjshme. Secili votues nga cili do qytet i botës apo shtet i botës, aplikon që ka me u regjistruar dhe me votuar dhe, e dërgon fletëvotimin. Këtu, nuk kemi asnjë dyshim dhe nuk kemi as pse me ja cenuar ose me ja mohu dikujt të drejtën, madje duhet me e mbrojtë këtë të drejtë...

**Sami Hamiti:** Për kolegun që tha se nuk ka pasur askush arsye për të bërë manipulime për komunën e Istogut, unë pajtohem me atë që tha Betimi dhe Adnani që në raundin e parë, tre asamblist kanë ardhur me vota komplet manipuluese. Ato janë faktuese sepse, ne e kemi bërë një ankesë tek PZAP-i dhe, ajo e konstaton që votat nga Mali i Zi që janë të manipuluar dhe ato vota i kanë zgjedh tre asamblist, dikush e ka pasur interes atë punë...! Nuk është çështje që është votim i rregullt sepse, ata janë njerëz që nuk janë të komunitetit serb, janë mysliman njëri prej tyre është bartës i listë së Vakait ku e ka votuar vetën me kusht, dhe vërtet i ka ardhur vota për njërin prej kandidatëve të Serbskës i ka ardhur vota prej jashtit, dikujt i ka konvnuar. Tash mos të bëjmë këtu politik me vendimi PZAP-it, është i saktë, dhe e ka dërguar në prokurori dhe prokuroria, duhet t'i gjej shkaktarët por që ka pasur manipulim ka pasur, dhe dikush ka pasur interes ta bëjë...

**Betim Gjoshi:** Unë e morra fjalën për ti bërë disa përmirësime rreth vendimit që e marrim por, pasi m'u përdor emri, nuk është shteti prej Zimbabves e deri në Mal të Zi, e prej

Serbisë deri në Hunduras votat prej diasporës dhe është e pa mbrojtur dhe manipuluese, këtë rast i ka zënë PZAP-i e ka marr një vendim dhe është manipuluar në raste tjera. Vendimi i PZAP-it por edhe të gjithë të gjeturat rekomandimet e BE-së rekomandojnë ti ndryshojmë rregullat kjo është temë tjetër. Ne, po mundohemi ti eliminojmë disa vërejtje sa i përket rivotimit në Istog që ka me ndodh në bazë të vendimeve të Istogut. Unë në faqen 4,5 ose kush e bën një draft vendimin me shkruar po kërkoj disa përmirësime të bëhen, te opsioni i parë që po duket që po kalon dash si opsion në pikën a dhe b, këto dy paragrafët është shkak mu ngjit ky i dyti, ky i pari me dal i dyti ku thuhet që “votuesit jashtë vendit nëse kanë ndonjë vërtetim që jetojnë jashtë vendit” ndërsa duhet me thënë: “votuesit e regjistruar jashtë Kosovës nuk dërgojnë dëshmi shtesë kthehen në listën e rregullt”. Ky është përmirësimi që duhet të bëhet me shkrim për vendim. Draftojeni edhe njëherë...

**Binak Vishi:** Ne, e nisëm me rendin e ditës që është caktimi i datës se rivotimit, edhëm në akordancë që të verifikohet lista e Raundit të Dytë të votave me kusht. Edhe data, edhe pse nuk po e themi, është e 17 dhjetorit gjë që mund të organizohet, dhe mendoj se duhet ta kryejmë dhe, nuk dua të përzihem në vendimet e panelit zgjedhor se, a është i drejtë apo jo...Tash, jemi për ta caktuar datën dhe për të procesuar më tutje. Nuk është hera e parë edhe e fundit që vendimet e panelit zgjedhor nuk na kanë pëlqyer por, ju kemi përmbajtur dhe i kemi procesuar me ato që na kanë rekomanduar në vendim. Tash, tradita do të vazhdoj. Unë jam që të caktohet data që po dihet se është 17 dhjetori dhe të vazhdohet me procedurat e tjera....

**Valdete Daka:** Jo rastësisht, unë pyeta së pari krye shefin që a mundet me na garantuar se a munden gjitha operacionet e parapara me ligj...! Po më duket që u arrit një akord, po e votojmë edhe formalisht... Kush është që nga lista e votuesve jashtë Kosovës të mos hiqet askush, por të verifikohen? Po, nuk ka nevojë me u friksuar kryeshefi sepse ne e kemi vendimin e PZAP-it sepse neve na detyron edhe na urdhëron që ti evitojmë të gjitha shkeljet të cilat, janë evidentuar nga PZAP-i. Ne nuk po hymë në ato a na pëlqen vendimi edhe ne e kemi obligim me zbatuar sepse është i plot fuqishëm dhe ne duhet ta zbatojmë ashtu siç është ky vendim.

**Enis Halimi:** Deri këtu, është në rregull nuk ka problem me këtë vendim të PZAP-it, nuk po e diskuton askush. Varianti që votojmë këtu kërkon me i suspenduar këto dy nene, për shkak të këtyre bartjeve...

**Valdete Daka:** Atëherë, kush është për këtë variant?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan vendimin e PZAP-s për rivotim

**Valdete Daka:** Faleminderit. Atëherë po i bie se mundemi edhe datën me e përcaktuar...! Atëherë, kush është që 17 dhjetori të jetë data kur do të bëhet rivotimi në komunën e Istogut? Kush është për?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan datën “17 dhjetor” për mbajtjen e Rivotimit nga Rundi i Dytë për Kryetar Komune në Komunën e Istogut

## **2. Këshilli për Operacione Zgjedhore**

*Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Operacional*

**Enis Halimi:** Në këshill, ishin dy variante. Me variantin për 17 dhjetor, në rregull, u krye.

**Sami Hamiti:** Vetëm e përmirëson Besniku variantin e 5 ditshit, sa kush e konfirmon se di me data, por për atë që u morëm vesh: një dokument të cilin e dëshmon vendbanimin, një numër telefoni të saktë dhe tjetra, që e ka një adresë të saktë elektronike ose diçka që e ka saktë, e që mund të komunikohet...

**Betim Gjoshi:** Ne, gjithë punën e bëmë që ta votojmë dhe nuk e pritëm Sekretariatit që të na konfirmoj se në bazë të këtij varianti a mundën me i organizuar zgjedhjet apo jo. Rreth varianteve: votuam që duhet m'i sjell dokumentet dhe ne, bëjmë edhe kampanjë të informimit me tërë mundësitë, me çka kemi m'i informuar që duet t'i sjellin këto dokumente shtesë...E kanë rekomanduar një datë shtesë: shtat ditë kujtoj, deri më sot një javë... Edhe pas kësaj, mbesin edhe 4-5 dit me votuar. Ata, duhet me treguar se, a është kohë e mjaftueshme...

**Valdete Daka:** Le të na tregon Sekretariati se, cilat janë datat për votim jashtë Kosovës!

**Adnan Rrustemi:** Ne, nuk e përcaktojmë periudhën. Pastaj, e kemi edhe për raund të dytë kur është afati caktuar, nuk i kanë më shumë se dy javë votim.... Unë, e kuptoj që është periudha e verifikimit por, nëse është një javë verifikim, edhe një javë votim...! Edhe unë mendoj që 5 dit janë mjaft për verifikim, dhe 5 për votim....

**Valdete Daka:** Mirë, atëherë duhemi me aprovuar këtë plan operacional. Edhe afatin e verifikimit na e dërgoni në e-mail. Duhet edhe fushata zgjedhore kur është, ajo i intereson. Atëherë fushata zgjedhore fillon me 11 dhjetor deri me 15 dhjetor. Pra prej 11 dhjetor deri me 15 dhjetor është fushata zgjedhore. Kush është për këtë plan operacional? Faleminderit.

Duhemi me i aprovuar fletëvotimet, ky është fletëvotimi i cili do të ketë ngjyrë tjetër nga raundi i parë. Atëherë, kush është për këtë dizajn? Faleminderit. A kemi diçka tjetër për të aprovuar? Shpenzimet e fushatës dihen, janë sikurse në raundin e parë. Faleminderit që keni qenë, suksese të gjithëve....

**Për KQZ**

**Valdete Daka, kryetare**

-----